REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

Nr. 2866/1 Prot. Tiranë, më 08.04.2025

URDHËR

Nr. 543, datë 08.04.2025

PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË POLICISË SË SHTETIT DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2025-2028

Në mbështetje të germës "l", pika 2 të nenit 55 e nenit 132, të Ligjit nr. 82/2024, datë 26.07.2024 "Për Policinë e Shtetit", pikës 2 të nenit 104, e germës "a", pika 2 të nenit 105 të Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 24.02.2025,

URDHËROJ:

1. Miratimin e "***Planit të Integritetit të Policisë së Shtetit dhe Planit të Veprimit 2025-2028***", bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Nga të gjitha strukturat qendrore, vendore dhe ato të veçanta të Policisë së Shtetit të caktohet personeli i posaçëm për zbatimin dhe monitorimin e masave të parashikuara në Planin e Integritetit të Policisë së Shtetit dhe Planin e Veprimit 2025-2028.

3. Dokumenti t`u prezantohet gjithë strukturave policore nëpërmjet shpërndarjes, publikimit apo veprimtarive promovuese.

4. Të gjithë strukturat që marrin detyrime nga ky dokument të raportojnë periodikisht pranë Drejtorisë së Standardeve Profesionale, një herë në 6-muaj *(korrik / janar)* për zbatimin e masave të parashikuara në Planin e Veprimit.

5. Drejtoria e Standardeve Profesionale, të raportojë një herë në vit për zbatimin e masave të parashikuara në Planin e Veprimit tek Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe Ministri i Brendshëm.

6. Koordinator për ndjekjen e koordinimin e zbatimit, vlerësimit, monitorimit dhe raportimit periodik për Planin e Integritetit të Policisë së Shtetit dhe Planin e Veprimit 2025-2028 do të jetë Drejtori i Drejtorisë së Standardeve Profesionale, në Policinë e Shtetit.

7. Me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e strukturave qendrore, vendore dhe të veçanta të Policisë së Shtetit.

8. Me kontrollin e zbatimit të këtij urdhri ngarkohet Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe Drejtori i Drejtorisë së Standardeve Profesionale.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Drejtues Madhor Ilir PRODA

REPUBLIKA E SHQIPERISE - MINISTRIA E BRENDSHME - DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT - DREJTORI

PLANI
I
INTEGRITETIT

2025 – 2028

Integriteti i organizatës së Policisë së Shtetit ka të bëjë me harmonizimin e përpiktë dhe respektimin e vlerave parimeve dhe normave të përbashkëta morale dhe etike.

Punuan: Policia e Shtetit Shqiptar

Prill 2025

Integriteti në organizatën e Policisë së Shtetit është dimension jetik për shërbimin që ofrojmë në mënyrë që ky shërbim të jetë ligjor, i hapur, transparent dhe të rrisë çdo ditë e më shumë besimin e qytetarëve tek Policia.

Aktualisht, përmes politikave dhe masave të marra, Policia e Shtetit po bën përpjekje të fuqishme për të rritur efikasitetin, trajtimin dhe cilësinë e shërbimeve publike dhe kështu, në mënyrë të dukshme e të konsiderueshme, po përmirëson integritetin brenda radhëve të saj.

Ne jemi të ndërgjegjshëm për shkallën dhe kompleksitetin e korrupsionit dhe të çështjeve të integritetit me të cilat përballemi, për shkak të fushës së gjerë të shërbimeve që ofrojmë dhe të rrezikut që ekziston për ushtrim të parregullt të detyrës nga punonjësit e Policisë, të cilin ne duhet ta menaxhojmë me llogaridhënie, me përgjegjësi dhe me efikasitet.

Ambicia jonë më e madhe është të vëmë në zbatim politika parandaluese të përgjegjshme, proaktive, të orientuara e mbështetura siç duhet mbi rrezikun, me synimin që të minimizojmë me efektivitet mundësinë për korrupsion dhe të rritim stimujt në mënyrë që punonjësit e policisë të mos tundohen që të përfshihen në shkelje.

Për këtë qëllim, ne si Polici e Shtetit kemi bërë përpjekje të strukturuara për të hartuar dhe zbatuar 2 (dy) Plane Integriteti, të cilët janë përmbyllur me sukses:

- ✓ Planin e Integritetit të Policisë së Shtetit dhe Planin e Veprimit 2020-2021,
- ✓ Planin e Integritetit të Policisë së Shtetit dhe Planin e Veprimit 2022-2024.

Po fillojmë zbatimin e Planit të Integritetit dhe Planit të Veprimit të Policisë së Shtetit 2025-2028, i cili vjen në një linjë edhe me Planin e Integritetit të Ministrisë së Brendshme dhe Planit të Veprimit 2025-2028;

Ky plan përcakton objektivat, linjat e aktivitetit dhe masat që duhen marrë për të rritur më tej politikat dhe praktikat parandaluese antikorrupsion dhe për të fuqizuar rezistencën organizative ndaj korrupsionit.

Ne e shohim këtë Plan Integriteti si bazë operative të sistemit funksional të menaxhimit dhe të integritetit, që do të donim ta arrinim, për t'i siguruar jetëgjatësi dhe për ta përmirësuar më tej.

Ne besojmë në potencialin e tij parandalues dhe në faktin se përmes masave të parashikuara, të rriten mundësitë për sukses dhe të reduktohen si probabiliteti për dështim, ashtu edhe niveli i pasigurisë të ndërlidhur me arritjen e objektivave të organizatës.

Ky Plan konsiderohet si një pjesë e rëndësishme e proceseve të përgjithshme planifikuese i lidhur me planet strategjike për zhvillim institucional dhe që shton aspektin e menaxhimit të riskut.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Drejtues Madhor Ilir PRODA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT - DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT DREJTORI

MIRËNJOHJE

Ky plan u rishikua nga Grupi i Punës i ngritur me urdhër nr. 154, datë 21.01.2025, "*Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit dhe Planit të Veprimit të Policisë së Shtetit, për periudhën 2025-2028*", të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

GRUPI I PUNËS:

Dhimitraq ZIU	Drejtoria e Standardeve Profesionale
Artan BAJRAKTARI	Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare
Miranda BOSHNJAKU	Drejtoria e Planifikimit dhe Administrimit të Trajnimit Policor
Arben NASUFI	Drejtoria e Standardeve Profesionale
Remzi BRAHIMI	Departamenti i Policisë Kriminale
Blerina TOSKA	Departamenti i Policisë Kriminale
Gazmend SHEHU	Departamenti për Sigurinë Publike
Berti KOXHAJ	Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
Gëzim BAJRAMI	Sektori i Auditit
Majlinda KURTI	Drejtoria e Antiterrorit
Edmond FIXHA	Drejtoria e Standardeve Profesionale
Lindita SHESHA	Drejtoria e Burimeve Njerëzore
Eliza PATAJ	Drejtoria e Integrimit dhe Planifikimit Strategjik
Anisa BOÇI	Drejtoria Juridike
Kreshnik KOKA	Prokurimet Publike

PËRMBAJTJA:

Fjala Hyrëse e Planit të Integritetit

Mirënjohje

I. Përmbledhje ekzekutive ..... Faqe 5

II. Identifikimi i fushave me risk në polici ..... Faqe 7

III. Qëllimi ..... Faqe 8

IV. Synimet dhe Parimet..... Faqe 8

V. Procesi i zhvillimit të planit të integritetit ..... Faqe 9

VI. Fazat e implementimit të planit të integritetit ..... Faqe 15

VII. Rekomandime ..... Faqe 15

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Çështjet e integritetit dhe luftës kundër korrupsionit në organizatat e administratës publike por jo vetëm, marrin një rëndësi të veçantë në tërësinë e përpjekjeve dhe masave për përmbushjen e standardeve e detyrimeve që ka vendi në kuadër të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Trajtimi i korrupsionit në agjencitë e zbatimit të ligjit, veçanërisht në Policinë e Shtetit është i domosdoshëm për të ndërtuar një institucion të fuqishëm dhe për të rritur besimin e publikut në agjencitë e zbatimit të ligjit. Forcimi i kapaciteteve të institucioneve të zbatimit të ligjit për të sfiduar dhe rezistuar korrupsionin është një nga mjetet kryesore për ta luftuar atë në mënyrë efektive. Prandaj një kuptim i plotë i manifestimeve të ndryshme të korrupsionit të policisë është thelbësor për të ndërtuar një qasje të duhur kundër korrupsionit në Policinë e Shtetit.

Ka nivele të ndryshme të korrupsionit të policisë që mund të demonstrohen përmes një shumëllojshmërie praktikash, nga korrupsioni i vogël ose ai i rrugës deri në korrupsionet më të rënda të policisë, që shkojnë deri në implikimin e drejtuesve në nivele të larta të drejtimit.

Për organizatën e Policisë së Shtetit menaxhimi i riskut mbi integritetin si një direktivë dhe standard i pranuar nga organizatat ligj zbatuese është një nga instrumentet kyç me anën e të cilit synohet të bëhet identifikimi, analiza dhe vlerësimi i rreziqeve të korrupsionit.

Përmbushja e kësaj direktive për një menaxhim efektiv të riskut ndaj korrupsionit është kryer me angazhimin e funksionarëve në nivel drejtues, të trajnuar për metodat e përdorura bazuar në standardet ISO EN 31000, EN 31010 për studimin e rrezikut të korrupsionit në Policinë e Shtetit.

Plani i Integritetit (PI) për organizatën e Policisë së Shtetit është një dokument strategjik dhe operacional, që synon parandalimin e korrupsionit në radhët e policisë, i cili u hartua mbi bazën e analizës së faktorëve të rrezikut që cenojnë integritetin. Ky dokument rikonfirmon përpjekjet e Policisë së Shtetit Shqiptar për të pasur një organizatë të shëndetshme që ti shërbejë publikut dhe gjithë komunitetit në përmbushje të objektivave e parimeve mbi bazën e të cilave udhëhiqet organizata.

Ky plan u hartua në përputhje me:

- Ligjin 82/2024, datë 26.07.2024, "Për Policinë e Shtetit";
- Rregulloren e Policisë së Shtetit, miratuar me Vendim nr. 112, datë 24.02.2025, të Këshillit të Ministrave;
- Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 dhe Planin e Veprimit për Zbatimin e Strategjisë 2024-2026[1], miratuar me VKM nr. 859/2024;
- Rekomandimeve të Raundit të Pestë të Vlerësimit të Grupit të Shteteve Kundër Korrupsionit[2] (The Group of States Against Corruption/GRECO), për miratimin dhe zbatimin e planeve konkrete të integritetit nga të gjitha ministritë, të cilat të përmbajnë një analizë sistematike të riskut të lidhur me integritetin, me të cilin mund të përballen drejtuesit e lartë dhe këshilltarët politikë gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe mekanizma të monitorimit dhe pajtueshmërisë etj.

[1] https://aksesdrejtesi.al/dokumenta/173624570vendim-2024-12-26-859.pdf

[2] https://rm.coe.int/raundi-i-peste-i-vleresimit-parandalimi-i-korrupsionit-dhe-promovimi-i/1680a0923c 9

Për arritjen e objektivave të forcimit të sundimit të ligjit, forcimit të integritetit, të vlerave e standardeve etike e profesionale të çdo punonjësi e strukture, plani përcakton masa konkrete, bazuara në një analizë të hollësishme të fushave e aktiviteteve në risk që cenojnë integritetin dhe rrezikojnë përfshirjen në korrupsion.

Është kjo arsyeja që ky plan në vazhdën e përpjekjeve për të pasur një organizatë sa më të imunizuar ndaj risqeve të korrupsionit, do të luajë një rol kyç për:

- *Menaxhimin e rrezikut të integritetit në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit, me fokus në fushat dhe makro-proceset më të ekspozuara ndaj risqeve të korrupsionit;*
- *Angazhimin e strukturave drejtuese, zhvillimin e kapaciteteve e rritjen e vetëdijes e kulturës nga të gjithë punonjësit me synim një parandalim e menaxhim efektiv të rreziqeve ndaj integritetit, evidentimit e parandalimit të keq sjelljeve, dekurajimin e "kulturës së heshtjes" dhe inkurajimin e denoncimit të veprimeve korruptive duke shfrytëzuar dhe mundësitë që ofron ligji "Për sinjalizuesit";*
- *Forcimin e bashkëpunimin me aktorët e brendshëm dhe partnerët ndërkombëtarë në funksion të përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në dokumentet strategjikë të reformave Antikorrupsion;*

Në vijim të zbatimit dhe monitorimit të detyrimeve të përcaktuar në Planin e Integritetit të Policisë së Shtetit dhe Planin e Veprimit 2022-2024, lindi nevoja për rishikim dhe përditësimin e këtij dokumenti për periudhën 2025-2028.

Në zbatim të urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 154, datë 21.01.2025 "*Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit të Policisë së Shtetit dhe Planit të Veprimit, për periudhën 2025-2028*", u ngrit grupi i punës i cili ka punuar me përgjegjësi dhe ka përfunduar Planin e Integritetit të Policisë së Shtetit dhe Planin e Veprimit 2025-2028, në zbatim të:

- Rekomandimit të Raundit të Pestë të Vlerësimit të Grupit të Shteteve Kundër Korrupsionit (GRECO), për miratimin dhe zbatimin e planeve konkrete të integritetit nga të gjitha ministritë dhe institucionet e varësisë;
- Planit të Integritetit dhe Planit të Veprimit të Ministrisë së Brendshme 2025-2028.

Ky plan është pjesë e rëndësishme e procesit të planifikimit që lidhet me planin strategjik të zhvillimit të organizatës së policisë dhe posaçërisht me zbatimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë Antikorrupsion, duke e renditur Policinë e Shtetit ndër institucionet avangardë për efikasitetin, transparencën dhe etikën në luftën kundër korrupsionit.

Ky Plan konsiderohet si një pjesë e rëndësishme e proceseve të përgjithshme planifikuese të organizatës, i lidhur me planin strategjik për zhvillim institucional dhe që i shton aspektin e menaxhimit të riskut.

Plani i Integritetit i rishikuar 2025 – 2028 përmban:

1. *Fushat dhe aktivitetet e ekspozuara ndaj korrupsionit, me risk për cënueshmërinë e integritetit.*
2. *Planin e Veprimit, në të cilin përshkruhen masat që do të merren, afatet, si dhe strukturat përgjegjëse që do të kryejnë aktivitetet e përcaktuara.*

Në vazhdën e përpjekjeve për të pasur një organizatë sa më të imunizuar ndaj risqeve të korrupsionit, ky plan do të luajë një rol kyç për përmirësimin e integritetit në strukturat e Policisë

së Shtetit, si dhe **synon** parandalimin e korrupsionit në radhët e policisë, e cila përbën në vetvete një përgjegjësi, që lidhet me analizën e detajuar të fenomeneve korruptive që cenojnë integritetin e policisë, faktorëve që ndikojnë në krijimin e këtyre fenomeneve, si dhe ndikimet që kanë ato drejtpërdrejt në veprimtarinë e Policisë, si dhe në opinionin publik.

II. IDENTIFIKIMI I FUSHAVE ME RISK NË POLICI

Grupi i punës çmoi se "*Matrica e Riskut të Integritetit*" e hartuar bazuar në standardet ISO 31000, të përmbajë **6 fusha të identifikuara si më të ekspozuarat ndaj riskut të integritetit dhe korrupsionit,** të përfshira në Planin e Integritetit 2025-2028, përkatësisht:

1. **Korrupsioni në strukturat e hetimi të krimit;**
2. **Korrupsioni burokratik në burimet njerëzore;**
3. **Korrupsioni në nivelin e ulët ose i ashtuquajturi korrupsioni i rrugës;**
4. **Korrupsioni burokratik në menaxhim;**
5. **Korrupsioni burokratik në prokurimin publik;**
6. **"Kodi i Heshtjes" dhe Ligji për "Sinjalizuesit dhe mbrojtjen e të dhënave";**

Këto fusha përfshijnë aktivitete dhe procese të cilat lidhen drejtpërdrejt me punën e Policisë së Shtetit si dhe perceptimin e publikut për të, ***do të vazhdojnë të jenë sërish pjesë e Planit të Integritetit dhe Planit të Veprimit 2025-2028, po kështu qëllimi, synimet dhe parimet mbi bazën e të cilave është hartuar ky dokument si dhe metodologjia e përdorur.***

Për identifikimin e këtyre fushave anëtarët e grupit të punës përveç administrimit të informacionit dhe problematikës që ndeshin çdo ditë, kanë marrë në konsideratë sondazhe të ndryshme që kryhen për perceptimin e publikut mbi punën e Policisë së Shtetit. Rezultatet e monitorimit dhe problematika e paraqitur në Planin e Integritetit 2022 – 2024, janë reflektuar në Planin e Rishikuar të Integritetit 2025 – 2028, me synim trajtimin me prioritet të problematikave të shfaqura dhe minimizimin e rasteve korruptive në Policinë e Shtetit.

Masat e parashikuara në këtë plan do të zbërthehen nga strukturat përgjegjëse qendrore dhe ato vendore, në aktivitete më të detajuara në raport me dinamikën e problematikat e integritetit në çdo shërbim e nivel përgjegjësie, për të qenë sa më kreative dhe konkrete në përmirësimin e tij.

Në 6 fushat/makro të Planit të Veprimit 2025-2028 proceset e analizuara rezulton të jenë:

- ✓ Identifikuar **21** ***rreziqe ose sjellje në rrezik për cënimin e integritetit gjatë viteve 2025-2028,*** *nga **18** të identifikuara në Planin e Veprimit 2022-2024;*
- ✓ Për të parandaluar e trajtuar këto rreziqe janë parashikuar **47** ***masa e veprimtari parandaluese gjatë viteve 2025-2028,*** duke përcaktuar përveç strukturave e personave përgjegjës edhe bashkëpunimin me agjenci të tjera e partnerë mbështetës, nga ***51*** *të identifikuara në Planin e Veprimit 2022-2024;*
- ✓ Përcaktuar ***46 tregues/indikatorë për vlerësimin e suksesit gjatë viteve 2025-2028,*** *nga **33** të identifikuar në Planin e Veprimit 2022-2024;*

- Parashikuar ***46 objektiva për tu përmbushur gjatë viteve 2025-2028,*** *nga 32 objektiva të parashikuara në Planin e Veprimit 2022-2024;*

III. QËLLIMI

Qëllimi i këtij plani është që të kontribuojë në fuqizimin e kapaciteteve që ka Policia e Shtetit Shqiptar për të minimizuar dukuritë negative që cenojnë integritetin.

Mbështetja për forcimin e kapaciteteve dhe rritjen e profesionalizmit në të gjithë aktivitetin e punës së punonjësve të Policisë së Shtetit sipas strukturave ku kryejnë aktivitetin dhe që nga analiza e kryer u përkasin fushave me risk të lartë e të cenueshme nga veprimet jo etike dhe jo ligjore të tyre, me synim përmbushjen e objektivit kryesor të politikave kundër korrupsionit, për të "shmangur" praktikat e korrupsionit para se ato të ndodhin.

IV. SYNIMET DHE PARIMET

Policia e Shtetit e realizon misionin e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi[3], përmes fushave të veprimtarisë policore:

a) Lufta kundër kriminalitetit në tërësi, krimit të organizuar dhe krimeve të rënda në veçanti.
b) Mbikëqyrja e kufirit shtetëror, kontrolli i hyrjeve-daljeve në kufi, si dhe trajtimi i shtetasve të huaj ose personave pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë.
c) Ruajtja e rendit, sigurisë publike, sigurisë rrugore nëpërmjet policimit në komunitet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nëpërmjet këtij plani, synohet rritja e integritetit dhe ulja e korrupsionit në strukturat e Policisë së Shtetit. Këto komponentë janë komplekse, dinamike dhe të vazhdueshme. Ato nuk përmbushen brenda një kohe të shpejtë, për këtë arsye ky proces nuk mund të konceptohet si një garë shpejtësie, por si një maratonë, përmbyllja me sukses e së cilës kërkon shumë vendosmëri, kurajë, energji dhe masa të shtrira në kohë.

Për sa më lart, ky dokument parashikohet të ketë një shtrirje kohore më të gjerë ku gjatë këtyre **4 viteve** parashikohen masa dhe aktivitete konkrete, në varësi të dinamikës së punës të Policisë së Shtetit, që synojnë përmirësimin e kapaciteteve në luftën kundër fenomeneve korruptive.

Plani i Integritetit bazohet në parimet e mirë përcaktuara në Ligjin 82/2024, datë 26.07.2024[4], "Për Policinë e Shtetit", përkatësisht:

- Ligjshmëria;
- Respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- Barazia dhe mosdiskriminimi;
- Profesionalizmi, integriteti dhe përgjegjësia në shërbimin publik;
- Hierarkia dhe llogaridhënia në ushtrimin e funksioneve;
- Transparenca dhe besueshmëria;
- Paanshmëria;
- Përgjegjshmëria;
- Ushtrimi i ligjshëm i diskrecionit;
- Legjitimiteti, përshtatshmëria dhe proporcionaliteti.

Në trajtimin e punonjësve të saj Policia e Shtetit udhëhiqet nga parimi i integritetit, objektivitetit,

[3] *Ligji nr. 82/2024 "Për Policinë e Shtetit", neni 8.*
[4] *Ligji nr. 82/2024 "Për Policinë e Shtetit", neni 7.*

meritës, transparencës, garantimit të zhvillimit të karrierës profesionale dhe mosdiskriminimit.

Mbi bazën e këtyre parimeve dhe atij të policimit në komunitet është ndërtuar e gjithë filozofia e veprimtarisë së policisë si një organizatë, e cila është pjesë e komunitetit dhe në shërbim të tij, marrëdhënie e cila funksionon mbi bazën e besimit reciprok dhe ndikon drejtpërdrejt në forcimin e imazhit e të integritetit, si një normë e pjesë e pandarë në procesin e menaxhimit në përputhje me kulturën organizative të Policisë së Shtetit Shqiptar në të gjitha nivelet e saj.

V. PROCESI I ZHVILLIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

A. KORRUPSIONI NË STRUKTURAT E HETIMIT TË KRIMIT

1. Veprimtaria në rolin e Policisë Gjyqësore

Për shkak të veprimtarisë së tyre, punonjës të hetimit të krimit dhe jo vetëm, në disa raste janë identifikuar që gjatë kryerjes së veprimeve procedurale në rolin e oficerëve të policisë gjyqësore, kanë abuzuar duke tjetërsuar provat në vendngjarje apo deformuar deklarimet e personave nën hetim apo personave që kanë dijeni për rrethanat e ngjarjes.

Rekomandohet mbikëqyrje më e rreptë ndaj veprimeve procedurale që kryejnë oficerët e policisë gjyqësore, si dhe analiza të detajuara për veprat penale të cilat pushohen apo pezullohen, me qëllim identifikimin e veprimeve procedurale të kryera nga punonjësit nëse ka veprime që tjetërsojnë ngjarjen, ka veprime të paplota si këqyrjet të cilat janë të pa tjetërsueshme apo të papërsëritshme, të cilat ndikojnë në favorizime të mundshme të autorëve të veprave penale.

2. Veprimtaria parandaluese e strukturave të hetimit të krimit

Për shkak të veprimtarisë së tyre dhe *"mundësisë"* për favorizime të personave me aktivitet kriminal është konstatuar se punonjës të caktuar kundrejt veprimeve korruptive bashkëpunojnë me persona me precedentë kriminale, duke u krijuar favore me synim mos goditjen e tyre apo dhënie informacionesh në lidhje me veprimtarinë e policisë në drejtim të hetimeve në ngarkim të tyre.

Shembulli në këtë drejtim është përfshirja e disa punonjësve në aktivitete kriminale në fushën e kultivimit të bimëve narkotike, ku personat që ushtronin këtë veprimtari jo vetëm nuk u goditën, por në disa raste edhe u favorizuan në këtë aktivitet kriminal.

Rekomandohet forcimi i kontrolleve e monitorimit, mbikëqyrja e vazhdueshme e punonjësve, rritja e ndëshkueshmërisë së tyre si dhe "gjurmimi" i pasurive që ata disponojnë, të cilat nuk justifikohen me të ardhurat e përfituara në rrugë ligjore.

3. Menaxhimi dhe keqpërdorimi i informacionit

Gjatë veprimtarisë së përditshme punonjës të strukturave të hetimit të krimit dhe jo vetëm, duke "shfrytëzuar" të drejtën që kanë në raport me strukturat e tjera në sistemet që ka në përdorim Policia e Shtetit, në disa raste duke shfrytëzuar këto aksese, informacioni i klasifikuar "Sekret shtetëror" është nxjerrë në rrjetet sociale apo iu është dhënë personave të tjerë, përfshirë edhe personave me rekorde kriminale.

Vlen të theksohet edhe fakti se për të shmangur sa më shumë keqpërdorimin e informacioneve dhe mundësinë e korrupsionit në punën e përditshme nga oficerët e policisë në PSH, duhet të

udhëhiqemi gjatë hetimeve tona nga zbatimi i parimit të proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit (si për shkak të përkatësisë besimit fetar, gjinor dhe racor).

Rekomandohet përcaktimi i rregullave më të sakta për përdorimin e sistemeve si dhe rritja e monitorimit dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme ndaj personave që kanë akses në informacion të klasifikuar "Sekret shtetëror", forcimi i kontrollit ndaj këtyre punonjësve si dhe ndërprerja e aksesit për ata që nuk përmbushin kërkesat dhe nuk janë të pajisur me CSP, apo largohen në detyra të tjera.

Rekomandohet përcaktimi i rregullave më të sakta për përdorimin e sistemeve si dhe rritja e monitorimit dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme ndaj personave që kanë akses në informacion të klasifikuar "Sekret shtetëror", **mbështetur në parimin "nevojë për njohje", si dhe** forcimi i kontrollit ndaj këtyre punonjësve si dhe ndërprerja e aksesit për ata që nuk përmbushin kërkesat dhe nuk janë të pajisur me CSP, apo largohen në detyra të tjera.

Rekomandohet organizimi i trajnimeve të vazhdueshme për punonjësit e policisë që merren me hetimin e këtyre çështjeve (vepra penale që lidhen me besimin fetar; vepra penale që kryhen nga/ndaj personave që i përkasin një grupi të caktuar gjinor dhe racor) me qëllim njohjen e mënyrës së funksionimit të këtyre grupeve shoqërore dhe përdorimin sa më efikas të këtij informacioni gjatë punës së tyre hetimore.

B. KORRUPSIONI BUROKTRATIK NË BURIMET NJERËZORE

1. Vlerësimi i aftësive individuale të punës:

Bazuar në të dhënat/informacionet e siguruara gjatë monitorimit të Planit të Integritetit 2022-2024, vlerësimi i rezultateve, ngritja në detyrë dhe rekrutimi vijojnë të mbeten fusha problematike.

Vlerësimi i aftësive individuale të punës bëhet në mënyrë periodike çdo vit dhe sa here nevojitet në rastet e transferimeve apo ngritjes në gradë.

Vlerësimet e punës në përgjithësi janë subjektive dhe nuk pasqyrojnë treguesit realë të performancës së punonjësve. Përsa i përket vlerësimit të aftësive individuale rekomandohet që të sigurohen tregues të matshëm të performancës së gjithsecilit punonjës, me qëllim vlerësimin objektiv të tyre.

Vlerësimet e punës në përgjithësi janë subjektive dhe nuk pasqyrojnë treguesit realë të rezultateve të punonjësve. Në lidhje me vlerësimin e aftësive individuale rekomandohet që të sigurohen tregues të matshëm të rezultateve të secilit punonjës, me qëllim vlerësimin objektiv të tyre.

Vlerësimi subjektiv ndikon drejtpërdrejt në transferimet dhe emërimet në pozicione drejtuese si dhe në pjesëmarrjen në procesin e konkurrimit për ngritjen në gradë të punonjësve që nuk i përmbushin realisht kushtet për tu promovuar në detyra më të larta në sistemin e menaxhimit të Policisë së Shtetit.

Plani i Ri i integritetit parashikon masa konkrete për promovimin dhe rekrutimin e gruas në polici, ngritja e tyre në pozicione drejtuese, si dhe rekrutimi i minoriteteve në Policinë e Shtetit.

Gjithashtu, një masë e veçantë është parashikuar për monitorimin dhe zbatimin e Procedurës së Standarde të Punës "Për Këshillat Konfidencialë", miratuar me Urdhër nr. 293, datë 18.02.2025 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

2. Procesi i Rekrutimit dhe promovimit në karrierë të punonjësve

Nga analiza e informacioneve të siguruara nëpërmjet mbikëqyrjes e monitorimit të procesit të rekrutimit dhe promovimit të punonjësve është konstatuar se ka mungesë transparence në lidhje me kriteret e vendosura në fillim të këtyre proceseve. Kriteret duhet të jenë ligjore, të mirë përcaktuara, të miratuara dhe në çdo rast duhet të shpallen para fillimit të fazës së aplikimeve.

Gjatë zhvillimit të konkurseve për rritje në gradë të punonjësve të Policisë së Shtetit është vënë re ndryshimi i vlerësimit/mënyra e përllogaritjes në mes të procesit të konkurrimit, kjo në kundërshtim me çfarë është parashikuar në aktet normative e administrative që e plotësojnë atë në lidhje me procedurën e konkurrimit për gradë në PSH.

Rekomandohet rritja e transparencës gjatë procesit të rekrutimeve dhe promovimeve, nëpërmjet rishikimit të procedurave Standarde të Punës në të gjitha fazat e rekrutimit, përfshirë testimin me shkrim, testimin e aftësive fizike, rikonceptimin e testit psikologjik dhe intervistës etj.

3. Emërimi në pozicione drejtuese të punonjësve që nuk plotësojnë kriteret

Konstatohet se punonjës të caktuar emërohen në pozicione drejtuese, ndërkohë që nuk plotësojnë kriteret ligjore, si për aftësitë profesionale dhe përshtatjes së vendit të punës me gradën. Shkak për këto emërime janë jo vetëm moszbatimi i kritereve ligjore, por edhe mungesa e një memorie institucionale në lidhje me karrierën e punonjësit.

Në karrierën e punonjësit mungojnë vlerësimet e performancës si në aspektin pozitiv ashtu edhe në aspektin negativ të konstatuar gjatë inspektimeve apo kontrolleve të ushtruara në mënyrë periodike.

Mungesa të dhënave në lidhje më aftësitë e treguara nga punonjësit në mënyrë periodike krijon hapësira për emërime të pamerituara.

Rekomandohet zbatimi rigoroz i kritereve ligjore, rritja e transparencës, konkurueshmëria e disa kandidaturave për çdo vend vakant dhe për çdo rast emërimi e promovimi në karrierë. Rishikimi i procedurave të vlerësimit individual të rezultateve të punonjësve të policisë.

C. KORRUPSIONI NË NIVELIN E ULËT OSE I ASHTËQUAJTURI KORRUPSIONI I RRUGËS

1. Veprime korruptive nga strukturat e kufirit dhe migracionit

Bazuar në monitorimin e Planit të Integritetit 2022-2024 dhe gjatë kryerjes së aktivitetit të përditshëm të strukturave të Kufirit dhe Migracionit ka punonjës policie të cilët në kundërshtim me parimet e Kodit të Etikës dhe në cenim të figurës së punonjësit të policisë favorizojnë e pranojnë ryshfet dhe në rastin më të keq përdorin sjellje shtrënguese ndaj shtetasve ne Hyrje/Dalje në PKK Kufitar për ti detyruar të paguajnë ryshfet.

Veprimet favorizuese në cenim të etikës dhe integritetit të këtyre punonjësve janë në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit dhe Procedurave Standarde për kriteret, rregullat e hyrje – daljeve të shtetasve në/nga territori i Republikës së Shqipërisë. Veprime favorizuese të veprimtarisë së kundërligjshme e kriminale në zonën kufitare si dhe mungesë bashkëpunimi me strukturat e tjera për forcimin e kontrolleve kufitare për mallrat kontrabandë apo trafiqe të tjera.

Raportet e Drejtorisë së Standardeve Profesionale dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore flasin për një numër të lartë punonjësish të konstatuar në shkelje të tilla të proceduar penalisht sipas Kodit Penal dhe të ndëshkuar administrativisht me masa disiplinore sipas kërkesave të Rregullores së Policisë së Shtetit.

Rekomandohet forcimi i monitorimeve dhe kontrolleve nga strukturat e brendshme si dhe nga strukturat e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, trajnim i punonjësve për njohjen e legjislacionit dhe procedurave të punës, ashpërsim i masave ndëshkuese. Përmirësim i akteve ligjore e nënligjore dhe minimizimi i instrumenteve shtrëngues dhe nxitës të veprimeve korruptive.

2. Veprime korruptive nga strukturat e policisë rrugore

Konstatohet se në aktivitetin e përditshëm të strukturave të shërbimit të Policisë Rrugore me gjithë përmirësimet e bëra dhe treguesit në ulje të korrupsionit (sondazhe e studime) ka punonjës policie të cilët në kundërshtim me parimet e Kodit të Etikës dhe në cenim të figurës së punonjësit të policisë favorizojnë dhe pranojnë ryshfete nga shtetas të konstatuar në kundërvajtje administrative në këmbim të mos ndëshkimit me masë administrative me gjobë dhe veçanërisht për shkelje që parashikojnë dhe sanksione plotësuese të tërheqjes së lejes së drejtimit apo dhe dokumenteve të automjetit.

Veprime të mungesës së administrimit e fshehjes së provave në vendngjarje aksidentale apo me dëme materiale, me pasoja të rënda në përcaktimin e fajësisë, veprime që bëhen për qëllim favorizimi e përfitimi, të trafikut të influencës (favorizim i personave me influencë), të ashtuquajturve "të fortë" etj.

Rekomandohet : Krijimi i një grupi të specializuar për hetimin e aksidenteve të rënda, i cili të bëjë auditime të rasteve dhe të japë rekomandime për përmirësim. Në këtë proces, auditimi ka kuptimin e një kontrolli sistematik dhe vlerësimi të cilësisë së punës që bëhet nga punonjësit e Policisë Rrugore në vendngjarje dhe të mënyrës si trajtohen aksidentet rrugore. Ai synon të identifikojë gabimet, mangësitë dhe mundësitë për përmirësim. Auditimi duhet të jetë një proces i vazhdueshëm, jo vetëm një kontroll i rastësishëm, në mënyrë që të arrihet përmirësimi i qëndrueshëm i punës në vendngjarje.

Përdorim të mjeteve të kontrollit elektronik të trafikut si radarë apo alkool testues në kundërshtim me përcaktimet e urdhrave, udhëzimeve dhe procedurave të punës, për qëllime përfitimi e presioni për përfitim.

Rekomandohet forcimi i monitorimeve dhe kontrolleve ndaj punonjësve nga strukturat e brendshme në veçanti nga Drejtoria e Standardeve Profesionale dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, të përmirësohet transparenca dhe llogaridhënia në publik, të monitorohen rubrikat në sistemet elektronike të Policisë së Shtetit ku regjistrohen personat e ndaluar përkohësisht në ambientet policore, të përmirësohet cilësia e trajnimeve të punonjësve për njohjen e legjislacionit dhe procedurave të punës si dhe të rritet ndëshkueshmëria në rastet e konstatimit të veprimeve të kundërligjshme nga punonjësit e policisë.

3. Veprime korruptive nga strukturat e sigurisë publike

Bazuar në monitorimin e Planit të Integritetit 2022-2024 dhe gjatë inspektimeve të ndryshme apo ankesave të marra nga qytetarët është konstatuar se në disa raste punonjësit e sigurisë publike si Oficerët e Patrullës së përgjithshme, apo punonjësit e Forcës Kombëtare të Sigurisë kanë ushtruar

dhunë të pajustifikuar ndaj shtetasve që kanë qenë pjesëmarrës në tubime si dhe ndaj shtetasve që janë shoqëruar nga Oficerët e Patrullës së përgjithshme shkelje të ndryshme.

Gjithashtu është konstatuar se janë tejkaluar afatet e shoqërimit të shtetasve në ambientet policore.

Rekomandohet që të rritet mbikëqyrja e kontrolli i eprorëve / superiorëve ndaj punonjësve që kryejnë veprime abuzive në shkelje të të drejtave të njeriut, të përmirësohet cilësia e trajnimeve si dhe të rritet ndëshkueshmëria në rastet e konstatimit të veprimeve të kundërligjshme nga punonjësit e policisë. Për këtë sugjerohet:

- Përdorimi i kamerave të trupit (duhet që çdo ndërveprim i punonjësve të sigurisë publike me qytetarët, të jetë i regjistruar për të shmangur abuzimet).
- Gjurmimi i patrullave në kohë reale me GPS (për të shmangur rastet kur policët devijojnë nga itinerari i caktuar për takime të dyshimta ose veprime korruptive).
- Krijimi i një platforme (web, faqe interneti), ku qytetarët dhe vetë punonjësit të raportojnë raste të abuzimit me detyrën.
- Të kryhet rrotacion i rregullt i punonjësve në pozicione kritike, për të shmangur krijimin e rrjeteve korruptive afatgjata, punonjësit duhet të lëvizin periodikisht në detyra të ndryshme.

D. KORRUPSIONI BUROKRATIK NË MENAXHIM

Në veprimtarinë e përditshme të strukturave të policisë së Shtetit, konstatohet se punonjës të veçantë abuzojnë me atributet duke përdorur pozitën e tyre si drejtues për përfitime personale që cenojnë jo vetëm figurën e tyre, por edhe imazhin e organizatës, përdorimin pa kriter të automjeteve zyrtare apo asetet e tjera të policisë.

Gjithashtu, në nivele të ndryshme konstatohet promovim i personave me karrierë të "dyshimtë" dhe të identifikuar si persona me lidhje të mundshme kriminale, apo përkrahje e subjekteve të veçanta për licencime, autorizime e leje të veçanta, të cilat janë atribut i Policisë së Shtetit.

Nga konstatimet dhe gjetjet, ka rezultuar se pjesa më e madhe e rekomandimeve për shkeljet lidhen me nivelet e ulëta (roli bazë) ndërsa niveli i mesëm e i lartë në përgjithësi nuk mbajnë përgjegjësi për performancën e dobët të strukturave që ata menaxhojnë. Shmangia e këtyre niveleve nga zinxhiri i llogaridhënies, ndërkohë që kompetencat janë të përqendruar në këto nivele, lë mundësinë që shkeljet të përsëriten dhe performanca të mos përmirësohet.

Rekomandohet që të rritet jo vetëm kontrolli, por edhe niveli i llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë për "shfrytëzimin" e kompetencave në mënyrë abuzive apo të dyshimtë.

Ngritja e nivelit të mbikëqyrjes si dhe fuqizimi i kontrolleve te brendshme përmes inspektimeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme si nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit posaçërisht Drejtoria e Standardeve Profesionale dhe nga strukturat e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

Përcaktimi i përgjegjësive në të gjitha nivelet e në mënyrë të veçantë tek nivelet menaxheriale, pasi ata janë përgjegjës për performancën e ulët sikurse janë përgjegjës për përmirësimin e situatës.

Këto masa do të tentojnë të mbajnë të pastër dhe do të risin motivimin e pjesës më të madhe të organizatës për të qenë punonjës me integritet të lartë.

E. KORRUPSIONI BUROKRATIK NË PROKURIMIN PUBLIK

Si edhe fushat e tjera të ekspozuara ndaj riskut të korrupsionit edhe procesi i prokurimit për mallra

e shërbime është i prekur nga korrupsioni, me risqe që lidhen me manipulimin e proceseve të tenderimit në këmbim të përftimit të favoreve nëpërmjet "korrupsionit ambiental", dhënies së ryshfetit, mitëmarrës etj.

Proceset e tenderimit mund të manipulohen në të gjitha fazat në të cilat kalon ky proces, përfshirë planifikimin për mallra e shërbime, përgatitjen e dokumentacionit dhe specifikimeve teknike, në pranimin dhe vlerësimin e ofertave, shpalljen e fituesit deri në lidhjen e kontratave favorizuese e klienteliste.

Angazhimi i ekipeve me integritet, njohës të legjislacionit dhe me formimin e nevojshëm profesional dhe transparenca e strukturave përgjegjëse të policisë në proceset e prokurimit publik është një nga kushtet e domosdoshme për të shmangur e luftuar këtë fenomen.

Rekomandohet përmirësimi i funksionit të Auditimit dhe forcimi i kontrollit për zbatimin e rekomandimeve, bashkëpunimi me strukturat përfituese për planifikimin e mallrave e shërbimeve, forcimi i kontrolleve të brendshme të planifikuara e të paplanifikuara, trajtimi me transparencë e sipas ligjit të sinjalizimeve dhe denoncimeve për abuzim e korrupsion, të cilat janë thelbësore për ruajtjen e integritetit të Policisë se Shtetit. Si rezultat i këtyre masave ndërmerren veprime për te përmirësuar sistemet dhe praktikat jo të mira të punës.

F. "KULTURA E HESHTJES" DHE LIGJI PËR "SINJALIZUESIT DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE"

Për shkak të natyrës së veçantë të punës në mjaft raste punonjësit e policisë krijojnë perceptimin se ata nuk i kupton si duhet komuniteti duke krijuar një lloj "solidariteti" ndaj kolegëve, që i bën të mos i raportojnë shkeljet dhe sjelljet korruptive të kolegëve të tyre pasi e shohin raportimin si një veprim më të urryer se vetë korrupsioni. Ky perceptim, i cili ndodh dhe në organizata të tjera merr formën e asaj që është quajtur "Kodi i Heshtjes", i cili është kthyer në një kulturë që ka në thelb mosraportimin e kolegëve.

Një instrument i rëndësishëm që i kishte munguar legjislacionit të vendit është dhe Ligji 60/2016, për "Sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve". Duke konsideruar:

- rëndësinë e sinjalizimit si një mjet i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit dhe forcimit të kulturës së integritetit në institucionin e Policisë së Shtetit, të cilat janë ndër objektivat kryesore të përcaktuara në Ligjin për Policinë e Shtetit dhe akte të tjera ligjore e nënligjore;
- se sinjalizimi është i lidhur ngushtë me krijimin e kanaleve për kryerjen e sinjalizimeve dhe krijimin e një mjedisi që inkurajon punonjësit të sinjalizojnë aktet korruptive;
- se me gjithë vlerën e rëndësishme të sinjalizimeve në media, në ushtrimin e të drejtës themelore të shprehjes, këto sinjalizime mund të shpien në dëmtimin e punës hetimore të Policisë së Shtetit ose të imazhit të saj;
- se për zbatimin me efikasitet të tij, duhet që ligji për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve të promovohet, në mënyrë që të njihet dhe kuptohet sa më mirë vlera e sinjalizimit si mjet kundër korrupsionit dhe forcimin e integritetit.

Në përmbushje të kërkesave të këtij ligji, Policia e Shtetit Shqiptar do të punojë për përmirësimin e zbatimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor, forcimin e kapaciteteve të njësive përgjegjëse të sinjalizimit në Policinë e Shtetit, shqyrtimin dhe hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

VI. FAZAT E IMPLEMENTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

Masat e propozuara në Planin e rishikuar për forcimin e Integritetit të Policisë së Shtetit janë përcaktuar pas një analize të hollësishme për identifikimin e burimit, prioritetin, subjektin përgjegjës për zbatimin e masës dhe konfirmimin e realizimit nga ana e zyrtarëve që do të jene përgjegjës për implementimin e Planit të Integritetit. Në këtë fazë masat e paracaktuara janë të karakterit rregullator, të ngritjes së kapaciteteve për implementim, si në sensin parandalues, por edhe ndëshkues.

Struktura e ngarkuar për implementimin e Planit të Integritetit do të jetë Drejtoria e Standardeve Profesionale, e cila në bashkëpunim me strukturat e saj, ato të MB, AMP, OJF dhe partnerët ndërkombëtarë, do të monitorojë dhe vlerësojë zbatimin e masave për përmirësimin e integritetit dhe do të informojë mbi problematikën dhe rezultatet nivelin e lartë drejtues të Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme.

Për implementimin dhe raportimin periodik të këtij plani, strukturat qendrore (Departamentet dhe drejtoritë qendrore), DVP e DVKM dhe të veçanta në Policinë e Shteti do të përcaktojë personat përgjegjës (jo më pak se dy punonjës me gradë Kryekomisar dhe më lart), të cilët do të raportojnë pranë Drejtorisë së Standardeve Profesionale, sipas një modeli të caktuar raportimi, çdo 6 muaj lidhur me aktivitetet e kryera në kuadër të këtij plani.

Struktura përgjegjëse në nivel qendror mbi bazën e raportimeve të strukturave vendore do të raportojë në fund të vitit tek Drejtori Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, mbi zbatimin e masave dhe problematikat e evidentuara.

Personat përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të masave të Planit të Veprimit dhe raportim do të përcaktohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

VII. REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E INTEGRITETIT NË POLICINË E SHTETIT

Për përmirësimin e integritetit në Policinë e Shtetit Shqiptar u hartua Plani i rishikuar i Veprimit në të cilin janë detajuar aktivitetet, personat/strukturat përgjegjëse, afatet kohore për secilin aktivitet si dhe treguesit/indikatorët për mënyrën e matjes së realizimit të aktiviteteve të parashikuara.

Pas miratimit të Planit të rishikuar të Integritetit të Policisë së Shtetit do të organizohen takime me strukturat qendrore e vendore për të prezantuar këtë dokument të rëndësishëm dhe për të dhënë udhëzimet për hartimin e Planeve të Veprimit të strukturave qendrore e vendore, përcaktimin e personave e stafeve që do të ndjekin e monitorojnë zbatimin e detyrave dhe të masave të parashikuara në këtë dokument.

Plani i veprimit do ti nënshtrohet një analize periodike gjashtë mujore me qëllim monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të masave si dhe rishikimin e realizimit të objektivave.

==========

PLANI I VEPRIMIT

PËR PËRMIRËSIMIN E INTEGRITETIT NË POLICINË E SHTETIT SHQIPTAR
2025 – 2028

ANALIZA E PROCESIT

A. KORRUPSIONI NË STRUKTURAT E HETIMIT TË KRIMIT

Objektivi .1 Rritja e integritetit dhe reduktimi i korrupsionit në strukturat e hetimit të krimit.

Nr.	Fusha me Risk	Masat dhe aktivitete	Struktura përgjegjëse	Struktura të tjera përgjegjëse	Indikatorë matës	Objektivi i vitit 2025	Objektivi i vitit 2026	Objektivi i vitit 2027	Objektivi i vitit 2028
1.1	Aksesi në dokumente të klasifikuara "Sekret shtetëror" dhe bazat e të dhënave të Policisë së Shtetit ku administrohet ky informacion.	1.1.1 Evidentimi i funksioneve në PSH që duhet të pajisen me CSP, bazuar në Listën e funksioneve në Policinë e Shtetit të miratuar nga Ministri i Brendshëm, (***që trajtojnë informacion të klasifikuar***) si dhe ata që kanë akses në sistemet që administrojnë informacion të klasifikuar.	Departamenti Policisë Kriminale, DVP-të, Drejtoria e Burimeve Njerëzore	Drejtoria e Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave dhe DTI	1.1.1 Numri i funksioneve që duhet të pajisen me CSP në Policinë e Shtetit.	1.1.1 Numri bazuar në strukturën aktuale (psh.1235)	1.1.1 Trendi zbritës ose rritës (*psh. sa % do rritet apo ulet ky numër, bazuar në ndryshimet strukturore që mund të bëhen*)	1.1.1 Trendi zbritës ose rritës në %	1.1.1 Trendi zbritës ose rritës në %
